

**Sacer Panniculus Christi - The Holy Swaddle of Christ that
John the Albanian left in Dubrovnik in 843 A. D.**

Abstract: *The essay focuses on one of the earliest medieval accounts known so far mentioning Albanians in Dalmatia. Upon his return from the Holy Land in 843 A. D., John the Albanian, a priest who was travelling to Venice, stopped in Ragusa, present-day Dubrovnik to see his co-national presbyter Sergius. He left him a chest of lead in custody. Should he not return within ten years, Sergius could open it. Priest John never returned and Sergius in his deathbed revealed the slab under which he had hidden the chest. However, the chest was never unearthed until 1040 A.D. Two years before that, the parish priest had gone on a pilgrimage to the Holy Land and when he returned to Dubrovnik, much to his surprise, he was told that the Republic of Ragusa and the archbishop had built a cathedral where the chapel once stood. Worried about the chest, he revealed the archbishop that legend had it that there was something precious lying under the floor. The priest and the archbishop together dug the chest up and found in it the Holy Swaddle of the Baby Christ along with the necessary authentic certificate. At long last, four centuries after its arrival in Ragusa, the Swaddle was publicly displayed.*

The story is narrated by Junius Resti, one of the most celebrated historians of Ragusa in his «Chronica Ragusina». Though published in 1893, the manuscript dates back to 1735 and was the result of previous research conducted by earlier historians; Resti was only the third who worked on it.

Also Fr Serafino Razzi O.P, mentions the Holy Swaddle of Christ in his «Storia di Raugia» (1595). After Resti and Razzi also Daniele Farlati S. I, devoted several paragraphs to the story of the Swaddle in his «Illyricum Sacrum» (1800) adding precious data. However, Resti's account remains the earliest apparently. In 1376, after having resided in different churches, the Swaddle was brought in the cathedral of Dubrovnik. In those years, there were prominent Albanian clergymen in Dalmatia such as Dominicus Topia O. P, bishop of Curzola and Andreas IV, archbishop of Dubrovnik (1388-1393) to mention a few, and several other minor figures. Of no less importance in that period was the involvement in the local politics of the Albanian prince Carolus Thopia, who was made "dux Dalmatie et Croacie" (1369-1376).

At present the Holy Swaddle of Christ is treasured in the cathedral of Dubrovnik in Croatia and leaves the church only once a year, on the feast of St Blasius, patron saint of the town.

Keywords: *Sacer Panniculus Christi, Swaddle of Christ, Albanian clergy, Carolus Thopia, Junius Resti, Chronica Ragusina, Daniele Farlati, Coletti, Illyricum Sacrum, Dalmatia.*

Studimi i maposhtëm i kushtohet relikes së quajtur «Shpërgani i Krishtit Foshnje» e cila ende sot e kësaj dite gjendet në katedralen e Raguzës (Dubrovnikut).

Fragmenti në gjuhën italishte që po paraqesim të parin asht marrë nga «Historia e Raguzës» (1735) e autorit raguzian Junius [Giugno] Resti¹.

Sipas dëshmisë që jep vetë Resti, këtë relike e solli nga Egjipti në Raguzë në vitin 843 prifti arbënor Gjoni. Ky ia la me amanet një farë Sergjit i cili ishte kurat i kishës së Shën Vitit. Mirëpo prifti arbënor nuk u kthye ma dhe kështu që kjo relike mbeti në Raguzë. Në latinisht relikja njihet me emnin *Sacer Panniculus Christi* ndërsa në kroatisht quhet *Isusova pelenica*.

Në shqip, përveç fjalës «pelena» zanafilla e së cilës duket qartë, gjuha jonë përdor fjalën «shpërgan – shpërganj», e cila vjen nga greqishtja *ἔσπαργανωμένον*.

Ndër dëshmitë e tre autorëve kryesorë që përmenden këtu, Giugno Resti, Serafino Razzi dhe Daniele Farlati S.I., duket se ma i hershmi asht Resti, por nga ana tjetër, ndër të tre, Farlati jep informacion ma të pasun.

* * *

Në parathanien që i prin botimit të naltpërmendun të akademisë jugosllave të shkencave, prof. Natko Nodilo thotë se Giugno Resti asht dhe mbetet një nga autorët ma të përpiktë të historisë së Raguzës. Ai, si senator që qe, pati mundësinë të konsultonte arkivat e republikës, falë kambës së randësishme dhe zyreve të ndryshme që ushtroi gjatë karrierës së tij, siç na kumton miku dhe bashkëkohësi i tij, atë Serafino Cerva. Asht e padiskutueshme vlere historike e ngjarjeve që ai citon, e padiskutueshme për deri ku arrijnë dokumentet e arkivave, me vite të sakta, të cilat autori i citon anash faqeve. Kuptohet, përse i përket zanafillës dhe kohëve të hershme të historisë së Raguzës, dokumentet e arkivit nuk mundën me e ndihmue si duhet prandaj do të merren me rezervë, thotë prof. Nodilo.

Giugno Resti ndërroi jetë në vitin 1735, në moshën 64-vjeçare, para se ta përfundonte veprën e tij të «Historisë së Raguzës» nga e cila kishte botue dymbëdhjetë vëllime, tue e lanë përgjysëm vëllimin e trembëdhjetë, atë të vitit 1451.

1 *Chronica Ragusina Junii Restii (ab origine urbis usques ad annum 1451); item Joannis Gundulæ (1451-1484), tek Monumenta spectantia historiam slavorum meridionalium, volume XXV, Digessit Speratus Nodilo, Zagabriae 1893, ff. 21-22.*

Ma tej prof. Nodilo thotë se shqyrtimin e arkivave të Raguzës ia patën lehtësue Restit dy pararendës të ndritun të tij. Nëse i besojmë atë Serafino Cerva-ës, dhe nuk kemi arsye pse mos t'i besojmë këtij dietari tepër të mirëinformuem, Resti, kur kishin kalue njëqind vjet, mori në dorë dhe plotësoi materialin që pati mbledhë me kohë Giovanni i Marino Gondola-ës i cili kishte vdekë në 1650-ën. Ky Giovanni Gondola qe kushëri dhe bashkëkohës i poetit të njohun dalmat Giovanni Gondola [kro. *Ivan Gundulić*], i cili, meqë këta të dy kishin emër dhe mbiemër të njëjtë, e quante veten «i biri i Francesco-s».

Giovanni i Marino Gondola-s qe mjaft i famshëm për detyrat që i ngarkoi Republika e Raguzës por edhe një studjues i vëmendshëm i historisë së saj, arsye për të cilën senati ia hapte arkivat për studim. Mbas një hulumtimi të gjatë, Giovanni kishte shkruar “Kronikën e Raguzës” që niste që nga themelimi i saj e deri në vitin 1484. Për bashkëqytetarët e tij Giovanni i Marino Gondola-s ishte *historiani i atdheut*, dhe gëzonte një nam të madh.

Po ashtu, Resti, – vazhdon prof. Nodilo – shfrytëzoi për «Kronikën» e tij edhe një tjetër historian, edhe ky i familjes së famshme raguziane Gondola. Bahet fjalë për Francesco Marino Gondola-n që kishte jetue në shek. XVI (pati ndërrue jetë në 1588). Ky pati qenë një jurist i shkëlqyeshëm i Raguzës dhe diplomat i saj. Me lejen e senatit, Francesco Marino Gondola kishte shqyrtue dokumentet në arkivat e republikës me synim që të shkruente historinë e Raguzës.

Tue pasë parasysh sa u tha ma nalt, mund të themi se «Kronika e Raguzës» asht fryt i studimeve të tre historianëve dhe të shkruemit e saj zgjati rreth dyqind vjet. Themelet e kësaj vepre i hodhën pikërisht mendjet ma të ndrituna të familjes Gondola – vijon në parathanien e tij prof. Natko Nodilo.

Qysh në shek. XVI Francesco Gondola bante kërkime nëpër arkive dhe merrte shenjime andej-këndeje nëpër fletë të shkëputuna. Këto shenjime i mori në dorë Giovanni Gondola në shek. XVII dhe i vuni në rend, tue shtue edhe shenjet e tij dhe tue i pasunue me mendimet e historianëve ma të njohun të kohës. Kësisoj, Giunio Resti, në shek. XVIII, mori në dorë shenjet e të parit dhe të dytit historian. Por fati i mbrapshtë i ndoqi të tre këta raguzianë pse asnjëni sish nuk arriti ta përfundonte «Kronikën e Raguzës». Siç thamë edhe ma nalt, Resti e la të papërfunduem vitin 1451 për shkak të vdekjes së papritun.

Duket se dorëshkrimi origjinal i Restit ka humbë por ne kemi dy dorëshkrime të kopjueme të veprës së tij nga pesë a gjashtë që ekzistojnë. Ky dorëshkrim i kopjuem asht: «Istoria di Ragusa, scritta da Giunio d'Antonio Resti e cavata dalle note di Francesco Gondola, 1735.» Një dorë tjetër, pak ma poshtë ka shkruar: «Carattere del P. Serafino Cerva dell'ordine de' Pred^{ri}. Ex Bibliotheca Raphaelis Radeglia». Kopja e origjinalit për të

cilën flitet këtu asht e vitit 1735, pra e po atij viti kur vdiq Resti. Kjo kopje, e cila iu dërgue akademisë jugosllave në Zagreb, ishte pronë e prof. Giuseppe Gelcich – dëshmon prof. Nodilo.

Kopja tjetër e origjinalit, asht edhe ajo bashkëkohore e së parës dhe, mban titullin: «Croniche di Ragusa, opera di Giugno Resti, senatore di Ragusa» Para titullit, në një faqe pararendëse ka të shkrueme: «Ex libris Michaelis Millisich». Qytetar i njohun i Raguzës, Milišić pati vdekë në vitin 1798, në moshën 87-vjeçare.

Pjesa e dytë e këtij vëllimi të akademisë jugosllave të Zagrebit përmban vazhdimin e historisë së Raguzës prej nga e kishte lanë Resti dhe ka këtë titull: «Croniche ulteriori di Ragusa. Probabilmente opera di Giovanni di Marino Gondola.»

* * *

I duhet dijtë për nderë atë Serafino Cerva-s i cili kopjoi dorëshkrimin e Restit dhe e ruejti dhe mandej ky dorëshkrim përfundoi në dorë të studjuesit të mirënjohun Giuseppe Gelcich të cilin albanologët e njohin kryesisht për librin e tij rreth Balshajve.

Por Cerva nuk asht i vetmi rregulltar katolik që ka shkruar rreth historisë së Raguzës. Një tjetër, asht dominikani atë Serafino Razzi. Pikërisht ky, në librin e tij «La storia di Raugia», vepër së cilës do t'i referohemi ma tej, na jep ma shumë informacion rreth familjes nga e cila rrjedhte edhe historiani Giugno Resti. Kështu, atë Razzi e rendit familjen *Resti* ndër familjet fisnike të Raguzës bashkë me atë *Sorgo*, të dyja këto me origjinë nga qytetit i Redonit në Arbëni. Po aty lexojmë se edhe familja tjetër fisnike e Raguzës *Luccari* ishte me origjinë nga Lezha².

A ishin të shumta familjet arbnore që morën pjesë në themelimin e Republikës së Raguzës, nuk mund ta dijmë me siguri, por mund të themi se edhe Giugno Resti, në këtë histori të tij të Raguzës thotë se në vitin 596 mbas Krishtit, shumë të krishtenë nga Bosnja dhe Arbënia, kur panë se qytetit i Raguzës po fuqizohej, u shpërngulën aty³. Por, megjithatë, siç pohon edhe prof. Nodilo, këto informacione rreth historisë së hershme të Raguzës duhen marrë «cum grano salis» - me rezervë. Në rasë të kundërt, pra, nëse këto të dhana janë të vërteta, atëherë duhet pranue se kemi të bajmë me një dëshmi të fuqishme të ekzistencës së arbënve në shek. VII në këto treva.

Dihet se në mesjetë ka pasë një tregti të mirëfilltë të relikeve të shenjtorëve prandaj rreth autenticitetit të relikes, i cili ka një randësi relative

2 Razzi, Serafino. *La storia di Raugia*, scritta nuovamente in tre libri, Vincentio Busdraghi, Lucca 1595, fq. 6.

3 *Chronica Ragusina*, vep. cit., ff. 18-19.

për historianët, do të mund të flasin ma gjanësisht analizat e laboratoreve të specializueme. Sidoqoftë, mënyra si asht endë, siç shihet nga fotografitë, fakti se i reziston zjarrit dhe nuk digjet, të bajnë të mendosh.

Sidoqoftë, ajo që na intereson ne këtu asht se qysh në vitin 843 mbas Krishtit, përmendet një meshtar arbnor me emrin Gjon, i cili ka lidhje me Raguzën dhe me Venedikun dhe në këtë pikë dokumenti asht krejtësisht i saktë sepse flitet për një periudhë kur tashma republika e Raguzës ekzistonte si e pamvarun dhe kishte arkivin e saj. Dokumenti ku flitej për këtë relike duhet të ketë ekzistue të paktën deri në kohën kur me «Kronikën e Raguzës» u pat marrë i pari historian i saj, Giovanni i Marino Gondala-s i cili pati vdekë në vitin 1650.

Pyetja tjetër se ç'lidhje mund të ketë pasë prifti Gjon *Arbnori* me Raguzën mund të shpjegohet me faktin se qysh në vitin 754 papë Zakaria i konfirmoi Andreut, arqipeshkvit të Epidaurit (kështu quhej Raguza e vjetër; sot quhet Cavtat) autoritetin e tij mbi ipeshkvijtë e Zakulmjes [Përtejkulmjes], Bosnjës, Tribunës, Kotorrit, Budues, Tivarit, Lezhës, Shkodrës, Drishtit dhe Pultit⁴.

Shpërgani i Krishtit në veprën e Restit «Chronica Ragusina»

[...] Poco tempo dopo ebber i Ragusei una fortuna da esser invidiata da tutte le nazioni, avendo acquistato il più bel tesoro, che sia al mondo, per esser unico. I Veneziani avevano negozj e traffichi, più che nessun altra nazione, in Soria ed Egitto, finchè da Sabba Moro non furono infestate quelle parti e quasi scacciati i cristiani.

Avvenne l'anno 843, che una galera veneziana, tornando d'Egitto, venisse per passo a Ragusa, e con quella trovandosi un prete di nazione albanese, nominato Giovanni, costui, portata una cassetina piccola e ben serrata, la lasciò a un tal Sergio, parroco o piovano della chiesa di s. Vito, con ordine che (la) custodisse sin alla sua tornata, che doveva esser fra poco, e che lui doveva esser riconosciuto per alcuni segni che aveva su la man sinistra. L'Albanese non tornò mai più, e la cassetta restò sotterrata in una parte della chiesa di s. Vito, con esser trasmessa la cognizione d'essa da piovano in piovano, sino agli anni 1040 di nostra salute, come un deposito, senza sapersi cosa fosse dentro. Ma occorre, che l'anno 1040 in circa Vital arcivescovo, procurando che la repubblica facesse fabbricar il palazzo per l'arcivescovo in quel luogo, dove si trovava la chiesola di s. Vito, essendo molto a proposito quel sito per l'abitazione dei prelati, così fu eseguito, e la chiesola restò occupata dalla fabbrica del palazzo arcivescovile, nella quale rimase sotterrata la cassetta. Intanto il piovano, che allora era di s. Vito, perché altri non sapeva il deposito

4 Po aty, fq. 20; krhs. Farlati, Daniele. *Illyrici Sacri*, tomus sextus, Venetiis 1800, fq. 24.

della cassetta, era ito a visitar i luoghi sacri di Gerusalemme, e tornato a capo di due anni, trovò fabbricato il palazzo e conobbe che della cassetta non si sapeva altro; onde confidò la cosa all'arcivescovo, il quale imaginandosi dover trovare in detta cassetta gioie, o altre cose di valore, non volle ammetter in sua compagnia altri che il piovano suddetto, e così di nascosto trovaronla nel medesimo luogo, dove era sotterrata, ed aperta a forza, trovarono dentro il Pannicello, nel quale fu involto dalla B. Vergine Cristo, Nostro Signore, bambino, con tutte le autentiche necessarie. Ciò visto dall'arcivescovo e dal prete, restarono di consentimento tener la cosa celata.

L'arcivescovo Vitale, sinché visse, lo tenne in gran venerazione, ma essendo venuto in punto di morte, fatta venire una sua sorella, abatessa del monastero s. Simeone e Giuda, glielo dono. La quale poi lo lasciò a monastero, ed allora la cosa fu pubblicata, con gran giubilo di tutta la citta. In detto monastero stette qualche tempo, finche, per alcun disordine, fu tolto dalla repubblica e riposto nel tesoro pubblico, dove le altre reliquie si conservavano, ed è in esser anche al giorno d' oggi, con tutte le disgrazie e dei terremoti e degl'incendj, successi a Ragusa, senza che alcuno, per molta diligenza che s'è fatta, avesse potuto riconoscer la materia, della quale è tessuto.

[...] Pak kohë ma vonë, raguzianët patën një fat që ua kanë zili të gjitha kombet sepse shtinë në dorë visarin ma të bukur që gjendet në botë, ngaqë ky asht i posaçëm. Venedikasit kishin punë tregtije dhe marrëdhënie ma shumë se çdo vend tjetër me Sirinë dhe Egjiptin derisa ato vende u pushtuen nga saraçeni Saba dhe të krishtenët pothuajse u dëbuen.

Ndodhi që në vjetin 843, një galerë venedikase, tue u kthye prej Egjiptit, u përshkue nëpër Raguzë dhe në të gjendej një prift i kombësisë arbnore, me emnin Gjon. Ky mbasi solli një peshtah të vogël dhe të mbyllun mirë, ia la këtë një farë Sergjit, famullitar apo pieban [një lloj detyret meshtarake] i kishës së Shën Vitit me amanet që t'ia ruente deri atë ditë kur ky të kthehej, që nuk do të ishte e largët, dhe se ky do t'a njihte nga disa shenja që kishte në dorën e majtë. Arbnori nuk u kthye ma dhe peshtahi mbeti i groposun në një anë të kishës së Shën Vitit, por njoftimi rreth tij u përçoll nga famullitar në famullitar deri në vjetin 1040 të Shëndetit Tonë, si një gja e lanë për rruajtje, pa e dëjtë se çka kishte mbrendë. Por ndodhi që në vjetin 1040, afërsisht, arqipeshkëv Vitali, nxori lejën që republika [e Raguzës] të ndërtonte në atë vend pallatin e arqipeshkëvit, në atë vend ku gjendej kishëza e Shën Vitit, meqë ai vend ishte mjaft i përshtatshëm si banesë për prelatët. Kështu u veprue dhe kishëza u zu nga ndërtesa e pallatit arqipeshkëv, në të cilin kishte mbetë i groposun edhe peshtahi. Ndërkaq, famullitari, i cili asokohe ishte i Shën Vitit, sepse askush tjetër nuk dinte gja për peshtahin, kishte shkue me vizitue vendet e shenjta në Jeruzalem, dhe kur u kthye mbas dy vjetësh, e gjeti pallatin e arqipeshkëvit të ndërtuem dhe mori vesh se nuk

u dinte gja për peshtahin. Kështu ia tregoi këtë gja arqipeshkvit, i cili tue mendue se në atë peshtah do të gjente gurë të çmueshëm ose gjana tjera me vlerë, nuk pranoi me marrë me vete askënd tjetër përveç famullitarit, dhe kështu, fshehtas, e gjetën në po të njajtin vend ku ishte groposë. Mbas e hapën me forcë, gjetën mbrenda Shpërganin, në të cilin u pat mbështjellë Krishti Foshnje, Zoti Ynë, nga Virgjina e Bekueme bashkë me të gjitha dëshmitë e nevojshme. Mbas e panë këtë gja kryeipeshkvi dhe prifti, ranë dakord që ta mbanin këtë gja të fshehtë.

Arqipeshkëv Vitali, përsa kohë jetoi, e mbajti në nderim të madh, por kur po vdiste, thirri një motër të tijën, abateshë e monastirit të Shën Simeonit dhe Tadeut, dhe ia dhuroi. Kjo mandej ia la monastirit dhe atëherë ngjarja u ba e njohun tue shkaktue gëzim të madh në të gjithë qytetin. Në këtë monastir qëndroi disa kohë, derisa për shkak të disa trazinave, republika e largoi andej dhe e depozitoi në visarin publik, aty ku ruhen edhe reliket tjera, dhe ku ekziston ende sot e kësaj dite [1735], me gjithë fatkeqësitë dhe tërmetet dhe zjarret që kanë ndodhë në Raguzë. Dhe askush, me sado vullnet që ka pasë, nuk ka mbërrijtë me gjetë materialin me të cilin asht endë.

Shpërgani i Krishtit në veprën «Historia di Raugia» të Razzi-t.

Në këtë vepër që cituem ma nalt, edhe atë Serafino Razzi, dominikan i Raguzës, flet rreth Shpërganit të Krishtit. Asht mjaft interesant fakti se Razzi, ndonëse nuk e përmend emnin e prift Gjonit që solli Shpërganin në Raguzë, thotë vetëm se ky qe arbnor dhe na dëshmon se edhe miku i tij Sergji ishte arbnor.

*[...]Dell'anno 842 capitò a Raugia una Galea grossa Viniziana con molti Signori oltramontani, i quali andavana in pellegrinaggio à i luoghi snti di Ierosolima: e fecero molte limosine à i poveri, & à i Monasteri. E dopo un'anno, venendo quell'istessa Galea di ritorno à Raugia, un certo Prete Albanese, che andava sopra di quella, contratta con don Sergio amicizia, per essere ambedue d'un istessa nazione, gli lasciò indisposito certa casetta, serrata à chiave, e con ordine, che la serbasse fino al ritorno suo di Vinezia. Ma poscia non ritornando, nè potendosi havere nuova alcuna di lui, dopo certo tempo, fu detta casetta aperta alla presensa del Vescovo, gentilhuomo Rauseo, e vi trovo dentro (come chiaramente veniva narrato in una carta pergamena, in quella rinchiusa) il panicello, ò velo, che vogliamo dire, in cui nostro Signore fu ricevuto da San Simeone, il giorno che fù dalla sua santissima Madre Maria, nel tempio presentato. [...]*⁵

5 Razzi, vep. cit., fq. 19

Megjithatë, siç pamë, Razzi përmend vitin 842 si vit të mbërritjes së Shpërganit në Raguzë dhe jo 843.

Por Razzi në këtë vepër të tij na jep dëshmi edhe ma interesante. E përmend prift Sergjin në një kontekst krejt tjetër. Ai thotë se Shën Hilarioni i Gazës, kur erdhi në Raguzë bani dy mrekulli: dogji kulshedrën dhe ndali cunamin që po shkatërronte qytetin. Dhe, simbas Razzit, kjo ndodhi në vitin 802 mbas Krishtit. Ma vonë Shën Hilarioni mori me vete Sergjin, dhe shkoi për ungjillëzim në Bosnje.

*[...] Il quale poscia se ne ritornò a Bossina, menando seco un Prete Cappellano di san Vito, chiamato don Sergio, Sacerdote di S. Vito, e per nazione Albanese. Il quale essendo istato seco alquant'anni, se ne ritornò a Raugia, havendo acquistato sotto il magistero di lui molta afezzione Christiana. [...]*⁶

Në këtë pikë, duhet të vemë në dukje se ka një mospërputhje në kronologji. Jeta e Shën Hilarionit nga Gaza tregohet nga Shën Jeronimi tek vepra e tij «*Vita S. Hilarionis*», dhe asht shkruar mbas viteve 386-390 mbas Krishtit, mbas udhëtimeve të shën Jeronimit në Siri dhe Egjipt⁷ dhe jo në vitin 802.

Siç shihet, gjurmët na çojnë larg por gjithmonë ka një lidhje me viset që përmenden në Testamentin e Vjetër dhe të Ri.

Farlati rreth Shpërganit të Krishtit tek «*Illyricum Sacrum*»

Të mbërritunit e Shpërganit të Shenjtë të Krishtit në Raguzë me anë të Gjon Arbnorit në vitin 843 na e vërteton gjanësisht edhe Farlati. Ky në dëshminë e tij me sa duket ka shfrytëzuar edhe burime të tjera sepse aty, ndryshe nga Resti thotë se Shpërgani u soll nga Palestina dhe jo nga Egjipti.

[...] Pontificatum Vitalis Archiepiscopi maxime illustravit Inventio Sacrosancti Panniculi, quo puerum Jesum involutum fuisse tradunt, cum in Templo Hierosolymitano a Deipara Virgine oblatum, S. Simeon Propheta in manus recepit, suisque ulnis complexus est. Fama & traditione a majoribus acceptum, & posteris traditum esse ajunt, navim Venetam anno 843. e Palæstina redeuntem ad portum Ragusii appulisse, qua Presbyter quidam, nomine Joannes, natione Albanensis, sive Epirota vehebatur. Is cum sacra Palæstinae loca, religionis & voti caussa lustraret pieque inviseret, Panniculum illum nescio unde, aut quomodo nactus est; quem plumbea capsula inclusum, & obsignatum secum retulit. Ragusium cum venisset, eique Venetias, aut alio, iter esset necessarium; Sergio Presbytero, Curatori Ædis & parœciæ S. Viti, populari suo, quem salutandi caussa convenerat,

6 Po aty, fq. 15.

7 Degórsky, Bazyl. *Il soggiorno di Sant' Ilarione di Gaza in Dalmazia secondo la Vita S. Hilarionis di San Girolamo*, tek *Vox Patrum* 37 (2017) t. 67, fq. 101.

*capsam illam commendavit, quid in ea rei contineretur, celatum esse voluit. Depositum illud ut diligentissime custodiret, etiam atque etiam admonuit; ejusque fidem obtinuit, quod acceperat, redditurum statim atque ille reversus reposceret. Joanne abeunte, Sergius capsam sibi creditam, ut quam tutissime servaret, uno de laterculis amoto, quibus constratum erat pavimentum Ecclesiae S. Viti, & scrobe effossa, ibi occuluit, sublatum laterculum reposuit, & circumcirca cum aliis laterculis, tam diligenti aptaque junctura connexuit, nihil ut rimæ appareret, quod rei subter latentis indicium esiet. Ille autem bonus Presbyter postea numquam rediit, nusquam apparuit. Quare Sergius morti jam proximus, locum, & capsam sub eo defossam indicavit successori in praefecturam ejusdem Ecclesiae designato; eumque admonuit, ut Joanni Presbytero Albanensi, si forte rediisset ac repeteret, depositum illud rederet, signis quibusdam ac notis expressis unde hominem agnosceret. Hujusmodi loci & capsulae notitia per plures deinceps aetates, quasi per manus tradita ex aliis ad alios ejusdem Aedis Curatores & Parochos pervenit. [...]*⁸

Ma tej, Farlati na flet edhe për fuqinë dhe mrekullitë që bani kjo relike, madje edhe për skizmatikët, si përshebull për princshën serbe⁹.

Shpërgani i Krishtit në veprën «Moćnik Stolne Crkve Dubrovačke» (1868) të autorit Stjepan Skurla.

Një vepër tjetër, ma e vonë në kohë nga këto që përmendëm deri këtu, asht ajo e kanonikut të katedrales së Raguzës, Stjepan Skurla. Ky autor në këtë inventar të relikeve të katedrales, i kushton Shpërganit të Krishtit një kapitull të tanë me titullin «Pelenica Isusova»¹⁰.

*Godine 1030 vraćajući se iz Misira jedan mletački brod, pristane za neko vrijeme u dubrovačkoj luci. Na tom brodu bijaše jedan pop, po imenu Ivan, rodod Arbanas; - ovaj se iskrca i otide u grad da pohodi nekoga popa Srgja – rodod kao i on iz Arbanije – koji bijaše župnik, iliti upravitelj, crkve sv. Vida. [...]*¹¹.

Siç shihet, edhe ky na dëshmon se të dy meshtarët, Gjoni edhe Sergji ishin nga Arbënia. Ma tej edhe Skurla na tregon, pak a shumë, ngjarjen si autorët e tjerë, por ka një ndryshim themelor: sipas tij relikja erdhi në

8 Farlati, Daniele. *Illyrici Sacri*, tomus sextus, Venetiis 1800, ff. 51-52.

9 Po aty, fq. 52.

10 Skurla, Stjepan. *Moćnik stolne crkve dubrovačke*, Dubrovnik 1868, ff. 121-144.

11 *Në vitin 1030, kur po kthehej nga Misiri, një anije venedikase u ndal disa kohë në portin e Raguzës. Në atë anije ndodhej një prift, me emnin Gjon, me origjinë Arbnor; ky zbriti dhe shkoi në qytet për të pa një prift, njëfarë Sergjit – me origjinë edhe ky nga Arbënia – i cili ishte famullitar apo mbarështues i kishës së Shën Vitit. [...]*

Raguzë në vitin 1030 dhe Sergji ishte ende gjallë kur u çel peshtahi me relikën brenda në vitin 1040. Në këtë rrëfim të gjatë, kanoniku Skurla na përcjell edhe disa të dhana të tjera. Relikja mbas vitit 1667 – me sa duket mbas tërmetit të atij viti – u çue tek kapitulli i dominikanëve ku qëndroi deri në vitin 1721¹².

Në vijim, Skurla, tue citue tregimet e dominikanit Serafin Cerva, na thotë se Cerva e kishte matë Shpërganin dhe përmasat ishin tre krahë raguzianë gjatësi dhe një krah raguzian gjanësi (një krah raguzian ishte i barabartë me 51 cm.). Pra, Shpërgani i shek. XVIII kishte një gjatësi rreth 1.53m¹³.

Tue pasë parasysh se brenda tekës së prarueme Shpërgani asht i palosun disafish, duket se përmasat janë të sakta. (Foto 1.)



(Foto 1. Courtesy of prof. Ivan Viđen)

Autori Skurla na thotë se vetëm dy herë janë marrë copëza relikesh nga kjo: njëherë për Sigismundin e Hungarisë në vitin 1396 dhe njëherë tjetër në vitin 1844, kur ipeshkvi i Raguzës Tommaso Jederliniq ia dhuroi kardinalit Giovanni Maria Mastai Ferretti-t i cili, dy vjet ma vonë, do të zgjedhej papë e do të merrte emnin Piu IX. Kjo relike gjendet në bazilikën liberiane, dmth në Santa Maria Maggiore në Romë dhe ka këto përmasa: shtatë gisht gjatësi

12 Skurla, Stjepan, vep. cit., fq. 128.

13 Po aty, fq. 129.

dhe pesë gisht gjanësi¹⁴. Siç vihet re fare qartë, Shpërgani ka një pjesë të dëmtueme, tue na dëshmue se prej tij janë marrë fragmente. (Foto 2)



(Foto 2. Courtesy of prof. Ivan Viđen)

Shpërgani i Krishtit simbas autores M. Bego-Urban tek «Škrinja uspomena» (2010)

Edhe studjuesja kroate Melita Bego-Urban pohon se vendi i origjinës i relikes asht Egjipti por jep si vit të gjetjes së Shpërganit nga arqipeshkëv Vitali vitin 1030 dhe jo 1040. Nga kjo e dhanë, vërehet se ajo ka marrë për bazë librin e kanonikut Skurla që porsa përmendëm. Po ashtu, në këtë vepër të sajën e cila asht një fjalor fjalësh të rralla që përdoren në Raguzë, Bego-Urban pohon se Gjoni dhe Sergji ishin arbën¹⁵.

Isusova pelenica koja se uz ostale moćnike i blaga nalazi u Riznici dubrovačke katedrale. Nosi se pod svodom u procesiji sv. Vlaha. Spominje se od 1030. Na povratku iz Misira mletački brod pristaje u Dubrovnik. Svećenik Ivan koji je plovio brodom, podrijetlom Arbanas, iskoristio je priliku da u gradi posjeti svog prijatelja i zemljaka svećenika Srđa, župnika crkve sv.

14 Po aty, fq. 130.

15 Bego-Urban, Melita. Škrinja uspomena: dubrovački jezični pabirci, Čibača: Humanitarno društvo Župe dubrovačke, Dubrovnik 2010, ff. 279-280.

*Vida u Pustjerini. Imao je olovni kovčezić koji je na odlasku ostavio Srđu na čuvanje uz uvjet da o njemu nikome ne govori i da ga čuva kao najveće blago dok se ne vrati. Ako ni za deset godine ne dođe može ga otvoriti [...].*¹⁶

Këto burime të ndryshme në kohë, por edhe të tjera që nuk i përmendëm këtu, dhe vetë ekzistenca e Shpërganit të Krishtit në Dubrovnik sot e kësaj dite, na vërtetojnë se kjo ngjarje asht plotësisht e vërtetë.

Shpërgani i Krishtit dhe kleri arbënor në Dalmaci

Duket se kujtimi i kësaj relikeje dhe i priftit që e sollti atë në Raguzë ka qenë gjithmonë i gjallë në atë qytet-shtet. Po ashtu, Atë Daniele Farlati na dëshmon se gojëdhana asht përcjellë gojë më gojë (tradita est ex aliis ad alios)¹⁷.

Por a kanë ndihmue famullitarët dhe prelatët arbën në Dalmaci ma vonë në mbajtjen gjallë të kësaj tradite?

Kjo asht pak e vështirë të pohohet me gojë plot por ama mund të themi se relikja asht vazhdimisht e lidhun me emnin, me ngjarjet e Arbënisë, të Raguzës dhe urdhnin e dominikanëve.

Me 8 tetor 1379, ditën e Shën Simeonit profet, relikja u çue përfundimisht në katedralen e Raguzës, na kumton Farlati¹⁸. Pikërisht në atë vit, Karl Topia hyni në aleancën e anzhuinëve kundër venedikasve¹⁹. Një rol të randësishëm në këtë aleancë pati luejt edhe Dominik Topia O.P., vëllai i Tanush Topisë dhe ungji i Karlit. Ky dominikan arbën, i cili qe edhe vikar i urdhnit dominikan në Shkodër, Kotorr, Shibenik, Raguzë, u përpoq me shtie në dorë Raguzën. Kështu, nga pozita e tij si ipeshkëv i Curzolas (Corcyrensis), ipeshkvi sufragane e Raguzës, nëpërmjet një besnikut të vet, njëfarë Todrit nga Drishti, imzot Dominik Topia thuri disa plane. Senati i Raguzës i ra në të dhe e dëboi në vitin 1360 bashkë me Todrin²⁰. Prej andej, Dominik Topia shkoi në Zarë, ku duket se edhe i mbylli ditët e veta. Karl Topia, ma vonë u ba dukë i Dalmacisë dhe i Kroacisë (dux Dalmatie

16 **Shpërgani i Krishtit**, i cili krahas relikeve dhe thesareve të tjera gjendet në Visarin e katedrales së Raguzës. Nxirret me shpurë në procesionin e Shën Vlashit. Përmendet që nga viti 1030. Një anije venedikase kur po kthehej nga Misiri u ndal në Raguzë. Prift Gjoni i cili po udhëtonte me anije, me origjinë Arbën, shfrytëzoi këtë rasë që t'i bante një vizitë në qytet mikut dhe bashkatdhetarit të tij, prift Sergjit, famullitarit të kishës së Shën Vitit në Pusteria. Kishte një peshtah plumbit të cilin kur po largohej ia la Sergjit që t'ia ruante me kusht që të mos t'i tregonte askujt për të dhe ta ruante si pasuninë ma të madhe deri sa të kthehej vetë. Nëse brenda dhjetë vjetësh nuk do t'u kthente, atëherë mund ta çelte [...]

17 Shih shenjimin 5.

18 Farlati, vep. cit. fq. 52.

19 Šufflay, Milan. Srbi i Arbanasi, Beograd 1925, fq. 116.

20 Po aty, fq. 117.

et Croacie) dhe si i tillë banonte rregullisht në Zarë. Me mbështetjen e aristokracisë kroate dhe të Sllavonisë, Karl Topia u shpall mbret i Hungarisë (mbas vitit 1385) por përfundoi tragjikisht, na tregon Šufflay²¹.

Pikërisht në ato vite, në krye të arqipeshkvisë së Raguzës (1388-1393), caktohet *Andreas IV*, nga Durrësi, edhe ky rregulltar i urdhnit dominikan. Kështu, burimet dominikane për imzot Ndreun nga Durrësi flasin me superlativa tue e përmend si një teolog të rrallë²². Po ashtu edhe Farlati na kujton se imzot Ndreu nga Durrësi qe një njeri shumë i përshpirtshëm dhe se kujdesej mjaft për arqipeshkvinë e tij. Në kohën kur drejtoi arqipeshkvinë e Raguzës, imzot Ndreu themeloi edhe një vëllazni që do të merrej me të vobektit, me pajën e vajzave jetime dhe me shpagimin e njerzëve që merreshin peng nga turqit²³. Gjithashtu caktoi edhe tre burra, njerëz të besuem të tij me u marrë me këto punë²⁴. Kur ndërroi jetë, në 1393, u varros në kishën e dominikanëve në Raguzë dhe nderimi për të qe i madh²⁵, sikurse dëshmon edhe varri i tij që duhet të gjendet aty sot e kësaj dite.

Një tjetër personalitet, rreth të cilit nuk mund të heshtet në këtë pikë, asht edhe Sigismundi i Luksemburgut. I njohun edhe si Sigismundi i Hungarisë, ky mbret anzhuin u ndal në Raguzë nga 21-28 dhjetor të vitit 1396, mbas betejës që kishte humbë kundër turqve në Nikopolis. Në Raguzë u prit me nderime të mëdha. Në atë rasë, mbreti i dha Gjergj Balshës II titullin «princ i Arbënisë» dhe e emnoi kont të vetin në Curzola dhe në Hvar²⁶. Pikërisht, gjatë këtij qëndrimi njëjavor, mbret Sigismundit iu dhurue nga qyteti i Raguzës edhe një pjesëz e relikes së Shpërganit të Krishtit²⁷.

Siç u tha, Shpërgani u dorëzue në katedralen e qytetit ditën e festës së Shën Simeonit, që bie me 8 tetor, por Kisha Katolike e kremton festën e të Paraqitunit të Krishtit në Tempull me 2 shkurt që asht edhe vigjilja e Shën Vlashit i cili kremtohet të nesërmen, me datë tre. Për këtë arsye edhe sot, Shpërgani i Krishtit del në procesion në Dubrovnik, nën një baldakin, ditën e festës së Shën Vlashit.

Pikërisht në procesionin e mbajtur në ditën e festës së Shën Vlashit në vitin 1588, ku pati qenë i pranishëm atë Serafino Razzi, siç dëshmon ai

21 Po aty, fq. 118.

22 P.F. Andræas à Dyrrachio Theologus præstantissimus, ad Ragusinam Sedem à Bonifacio IX. Pont. Max. primo sui Pontificatus anno, qui fuit Christi nati 1389., promotus est, quam annis quatuor apostolicus Pastor singulari pietate rexit. [...] Shih: Maria Fontana, Vincentio. *Sacrum Theatrum Dominicanum*, 1666, fq. 95.

23 Farlati, vep. cit., fq. 141-143.

24 [...] tres bonos viros probos, ac fide dignos Petrum de Svinis de Drivasto, Petrum Caputatis de Albania & Petrum [...]. Po aty, fq. 141.

25 Po aty, fq. 142

26 Šufflay, vep. cit. fq. 118.

27 Skurla, Stjepan, vep. cit., fq. 129.

vetë, mori pjesë edhe ipeshkvi i Lezhës, një françeskan:

[...] *comparsero gl'Abbati di Mitra, e doppò il Vescovo d'Alessio, frate Minore, e gentil'huomo Albanese [...]*²⁸

Prap, meshtarët me origjinë nga Arbnia nuk mungojnë as në vitin 1844. Pikërisht në këtë vit, kur hartohet edhe lista e relikeve në katedralen e Raguzës, kanoniku që ven firmën në fund mbas të tjerëve, si sekretar, quhet Niccolò Arbanas²⁹.

* * *

Në lidhje me Shën Vlashin dhe me ipeshkvijtë arbën, prap Farlati-Coletti na dëshmojnë se ishte pikërisht ipeshkvi i Lezhës Mëhill Kryezesi që i kishte nisë një relacion në vitin 1791, rreth historisë së këtij shenjt, kanonikut të kishës së Makarska-ës, provincialit të françeskanëve, atë Gjon Jozef Pavloviq Luçiq-it, ku thuhet se Shën Vlasi vinte nga qyteti i Sebastes në Arbëni. Këtë letër, nga miqësia që kishte me Luçiqin, e kishte në dorë edhe Coletti³⁰ tashma.

[...] *Neque abs re nostra erit, si ea hic referam, quæ de loco, ubi D. Blasius & Episcopatum gessit, & vitam pro Christiana religione profudit, nuperrime comperi ex litteris Michaelis Criesesii Episcopi Alexiensis an. 1791 datis ad nobilem virum, & Ecclesiæ Macarensis Canonicum atque Provicarium Joannem Josephum Paulovichium Lucichium, cujus familia ante quadringentos annos & domicilio & civitate Ragusina plurimum claruit, quemque mihi amicitia conjunctissimum, & de re literaria, atque ecclesiastica optime meritum honoris causa nomino. Scribit itaque Criesesius, in Albanix finibus antuquæ urbis rudera conspici, cui Sebaste nomen, & proxima Patrum Franciscanorum domus Sebastena dicitur; ibi in ipsa urbis porta lapis extitit prægrandis, cui hæ literæ inscriptæ Agricolo Præsidi..., cæteras vetustas exedit. Proxime mons adjacet Arga appellatum coomuni illus gentis vocabulo; & qui eo circum ventitant pastores regionis, se patria lingua **mbe Giutet Agricoles** id est ad urbem Agricolai pergere ajunt.*[...] ³¹

Gjithashtu, shprehja në gjuhën shqipe «mbi qytet të Agrikoles» të cilën Coletti e ka kopjue shkronjë për shkronjë, na tregon se ndoshta imzot

28 Razzi, vep. cit., fq. 136.

29 Skurla, Stjepan, vep. cit., fq. 29.

30 Zakonisht thuhet se Daniele Farlati asht autori i «Illyricum Sacrum», e në fakt, vepra mban emnin e tij por në të vërtetë, ky nxori në dritë vetëm katër vëllimet e para. Ndërsa vëll. V, VI, VII dhe VIII i botoi ndjekësi i tij besnik, Giovanni Iacopo Coletti (1734-1827). Edhe ky, jezuit, vijoi të punonte mbi materialin që kishte grumbullue Farlati si edhe ai vetë. Duhet theksue se në këtë pasazh asht Coletti ai që flet, aq ma tepër që letrën e Kryezesit hartue në 1791. Atë Farlati (1690-1773) nuk do të kishte muejt me e pa sepse kishte ndërrue jetë prej kohësh.


31 Farlati, vep. cit., ff. 48-49.

Mëhill Kryezesi e kishte hartue relacionin e tij në gjuhën shqipe³².

Siç shihet kremtimi i festës së Shën Vlashit, historia e këtij shenji dhe dalja në procesion e Shpërganit të Krishtit atë ditë, lidhet me fije të shumëfishta me klerikët arbënor dhe Arbëninë.

Dokumenti që shoqnon relikën

Siç pamë deri në këtë pikë, dokumentet historike që flasin për këtë relike duhet të kenë qenë ma shumë se një meqë të dhanat që përcjellin autorët e përmendun në këtë studim, sadoqë përputhen në shumë pika, prap kanë ndonjë ndryshim të vogël mes tyre. Po ashtu, të tre autorët kryesorë Resti, Razzi dhe Farlati dëshmojnë se kur u çgropos peshtahi, brenda tij u gjet relikja bashkë me dokumentin shoqnes. Kjo theksohet nga këta historianë sepse reliket nuk kanë vlerë nëse nuk janë të autentifikueme. Por megjithatë, sot për sot, dokumenti ma i vjetër që shoqnon këtë relike të katedrales së Ngjitunit të Zojës në Qiell [kro. *Katedrala Velike Gospe / Uznesenja Marijina*] asht i vitit 1864, siç shihet ma poshtë (Foto 3) me nënshkrimin e imzot Vincenzo Zubranich, ipeshkëv i Raguzës.



(Foto 3. Courtesy of prof. Ivan Viđen)

32 Për më tepër rreth relacioneve të imzot Mëhill Kryezesit, shih: Mirdita në arkivat e Propagandës Fide, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë 2020, ff. 167-201.

Tashti, që *authentica* shoqnuese e relikes asht e vitit 1864 dhe jo ma e hershme, shpjegohet me faktin se në tërmetin e 6 prillit 1667 në Raguzë u shkatërrue krejtësisht arkivi dioqezan bashkë me pallatin e arqipeshkvit dhe dokumenti origjinal nuk u gjet ma siç na tregon bashkëpunëtori i arqipeshkvisë aty dhe kritiku i artit prof. Ivan Viđen.

Certifikata e masipërme nuk ruhet në arkivin e katedrales por në Arkivin Shtetnor të Dubrovnikut në koleksionin e Dr. Ernest Katić, (HR-DADU-276), kutia nr. 11, na saktëson prof. Viđen.

Autori dhe revista «Shejzat» i shprehin falenderimet autoriteteve kishtarë të Katedrales së Dubrovnikut si edhe prof. Ivan Viđen për fotografitë, për *authentica*-n dhe shpjegimet përkatëse.

BIBLIOGRAFI

Bego-Urban, Melita. *Škrinja uspomena: dubrovački jezični pabirci*, Čibača: Humanitarno društvo Župe dubrovačke, Dubrovnik 2010.

Chronica Ragusina Junii Restii (ab origine urbis usques ad annum 1451); item Joannis Gundulae (1451-1484), tek *Monumenta spectantia historiam slavorum meridionalium*, volume XXV, Digessit Speratus Nodilo, Zagabriae 1893.

Degórsky, Bazyl. *Il soggiorno di Sant' Ilarione di Gaza in Dalmazia secondo la Vita S. Hilarionis di San Girolamo*, tek *Vox Patrum* 37 (2017).

Farlati, Daniele. *Illyrici Sacri*, tomus sextus, Venetiis 1800.

Maria Fontana, Vincentio. *Sacrum Theatrum Dominicanum*, Roma 1666.

Razzi, Serafino. *La storia di Raugia*, scritta nuovamente in tre libri, Vincentio Busdraghi, Lucca 1595.

Skurla, Stjepan. *Moćnik stolne crkve dubrovačke*, Dubrovnik 1868.

Šufflay, Milan. *Srbi i Arbanasi*, Beograd 1925.